

**Prishtinë, 30 mars 2011**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_359\_2011**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

Bazuar në:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna me Nenin 14.2 dhe Nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.034/L-185;
2. Dispozitat e Nenit 10, 11, 13.4 dhe 17 të Ligjit për Energjinë Nr.03/L-184;
3. Dispozitat e Nenit 9 të Ligjit për Energjinë elektrike Nr.03/L-201;
4. Dispozitat e Nenit 3 të Rregullës për Parimet e llogaritjes së tarifave në sektorin e energjisë elektrike (Rregulla e çmimeve);
5. Udhëzimin Administrativ Nr. 06/2007 për Caqet Indikative për konsumin e energjisë elektrike dhe termike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimi, dhe
6. Rregullën për krijimin e Sistemit të Certifikatave të Origjinës për Energjinë Elektrike të Prodhuar nga Burimet e Ripërtëritshme, Mbeturinat si dhe nga Bashkëprodhimi i kombinuar me Nxehësinë, në një njësi të vetme Gjeneruese;
7. Rregullën për Mbështetjen e Energjisë Elektrike për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës dhe Procedurat për pranim në Skemën Mbështetëse

**në seancën e mbajtur më 30 mars 2011 nxori këtë:**

**VENDIM**

1. Përcaktohen tarifat nxitëse Feed-in për prodhimin e energjisë elektrike të prodhuar nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë.
2. Tarifat Feed-in vlejné për kapacitetet gjeneruese me teknologji të re dhe me pajisje të reja.
3. Burimet primare të energjisë së ripërtëritshme që përdoren në prodhimin e energjisë elektrike të pranuar në Skemën e mbështetjes janë si në tabelat në vijim:

**Tabela 1** Kapaciteti i instaluar i nevojshëm për përmbushjen e Cazeve Indikative për konsum nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, të përcaktuara nga Ministria përgjegjëse për energji (MW)

<b>BRE</b>	<b>2007</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>
Hydrocentralet (<10MW)	26.5	28.3	30.5	32.9	35.1	37.5	40.0	42.7	45.5	48.4
Era	0.00	0.00	0.00	14.9	31.4	49.6	69.4	91.2	115.1	141.5
Solare PV	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Biogaz dhe Biomassë	0.00	0.00	0.00	0.00	0.2	0.3	0.3	0.4	0.5	0.5



**Tabela 2** Shkalla tipike e normës vjetore të prodhimit (MWh/MW) të teknologjive të gjenerimit të energjisë elektrike duke përdorur burime të ndryshme primare të energjisë së ripërtëritshme

Burimi primar i energjisë së ripërtëritshme	(MWh/MW)
Hydrocentralet (<10MW)	4758
Era	2190
Energjia solare	2059
Biogazi dhe Biomasa	4980

**Tabela 3** Tarifa Feed-in e aplikueshme për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme dhe të pranuar në Skemën e mbështetjes

Burimi primar i energjisë së ripërtëritshme	(€/MWh)
Hydrocentralet (<10MW)	63.3
Era	85.0
Energjia solare	j/a
Biogazi dhe Biomasa	71.3

4. Paguesa që nuk riimburohet e që duhet të paguhet nga operatori i njësisë gjeneruese që aplikon për pranim në skemën mbështetëse përbëhet nga pjesa fikse prej 4,000 eurosh, të cilës i shtohen 1,000 euro për çdo MW kapacitet të instaluar.
5. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
6. Vendimi shfuqizon vendimet e mëparshme V\_141\_2008 dhe V\_136\_2008 që kanë të bëjnë me tarifën e energjisë së prodhuar nga era dhe energjisë së prodhuar nga uji.
7. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe vlen për të gjitha Aplikacionet për Autorizim që dorëzohen në ZRRE pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda katërmëdhjetë (14) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së**

\_\_\_\_\_  
Dr. Ali Hamiti, kryesues

\_\_\_\_\_  
Përparim Kabashi, anëtar

\_\_\_\_\_  
Blerim Koci, anëtar